



Prishtinë: 23.02.2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_797\_2016

### Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energji

#### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragradi 1.6, nenin 14, paragrafi 2, nën-paragradi 2.14 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_1438\_01\_16**;
- Inicimi i kontestit nga Wind Power sh.a. i datës 13.05.2015

në seancën e mbajtur më datë 23 shkurt 2016, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I APROVOHET kërkesa e gjeneratorit Wind Power që energjia e prodhuar për periudhën 06/2010 deri më 06/2011 në sasi prej 757.153 MWh, t'i paguhet nga KEK-u me çmim prej 60 €/MWh;
- II OBLIGOHET Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve në ZRRE që për implementimin e këtij vendimi gjatë procesit të shqyrtimit tarifor SHTE10 (2016-2017) t'i lejojë këto kosto shtesë KEK-ut për mbulimin e këtij transaksi.

#### A R S Y E T I M

Pranë Zyrës së Rregulatorit për Energji (ZRRE) me datë 13.05.2015, është iniciuar kontesti nga Wind Power Sh.A kundër KEK Sh.A lidhur me: *Kompenzimin nga KEK sh.a për energjinë e prodhuar nga gjeneratorët e erës në Golesh ku vlera e kontestit është 757.153 MWh apo 45,429.18€ (pa përfshirë TVSH)*.

Kompania Wind Power sh.a me datë 03.03.2009 ka bërë kërkesë në ZRRE për ndërtim të kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërritishme të energjisë (BRE) – erë, që përbëhet prej tre (3) turbinave, secila me nga 450 kW, me kapacitet instalues të tërësishëm prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, zona kadastrale Harilaq, KK Fushë Kosovë

ZRRE pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të dorëzuar nga Aplikuesi Wind Power sh.a, me datë 22 shtator 2009 ka lëshuar Vendim nr. V\_205\_2009 mbi Autorizimin Preliminari dhe ka udhëzuar Aplikuesin që t'i plotësojë kushtet tjera ligjore që kerkohen me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë. Pas Vendimit mbi Autorizimin Preliminari nr.V\_205\_2009 të datës 22.09.2009, kompania Wind Power ka parashtruar në ZRRE kërkesën për shëndrrimin e Autorizimit Preliminari në Autorizim final.

Bordi i ZRRE-së në seancën e mbajtur me datë 29 dhjetor 2009 ka shqyrtuar kërkesën e Wind Power Sh.A për shëndrrimin e Autorizimit Preliminari në Autorizim Final dhe ka nxjerr vendim duke i lëshuar



**AUTORIZIM** kompanisë Wind Power për ndërtimin e kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërtritshme të energjisë (BRE) – erë, që përbëhet prej tre (3) turbinave, secila me nga 450 kW, me kapacitet instalues të tërësishëm prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, zona kadastrale Harilaq, KK Fushë Kosovë.

Pas kësaj me datë 8 qershor 2010 Korporata Energetike e Kosovës Sh.A (KEK) dhe Kompania Wind Power Sh.a kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë (MBE) në lidhje me kompleksin për gjenerimin e energjisë së erës me fuqi prej 1.35 MW (Bruto) në malin e Goleshit. Në marrëveshjen për blerjen e energjisë mes KEK dhe Wind Power, palët janë pajtuar që tarifa stimuluese “feed in tariff” të jetë 84 €/MWh, konform vendimit të ZRRE-së D\_141\_2008 të datës 19 dhjetor 2008. Këtë marrëveshje për blerje të energjisë KEK e ka dërguar në ZRRE për Aprovim.

Mbështetur në dispozitat e nenit 21 paragrafi 6 të Ligjit Energjinë Elektrike, ZRRE me datë 7 korrik 2010 i ka dërguar një njoftim KEK-ut duke e njoftuar se Marrëveshja për Blerje të Energjisë nuk i plotëson kriteret për tu miratuar për arsy se çmimi i synuar i blerjes së energjisë nga KEK-u prej gjeneratorit prej 84€/MWh bazohet në vendimin e ZRRE nr. D\_141\_2008 të datës 19 dhjetor 2008, e në të cilin vendim thuhet se ky çmim është i vlefshëm vetëm për energjinë e prodhuar nga gjeneratorët me pajisje të reja, ndërsa gjeneratorët e kompanisë Wind Power Sh.A nuk janë pajisje të reja ngase kanë qenë të instaluara më herët. Po ashtu ZRRE ka analizuar edhe të dhënat financiare dhe energetike të spefikuara në nenin 5 të MBE-se dhe në Aplikacionin e kësaj kompanie me ç'rast ka vlerësuar se duke marr për bazë të gjitha këto të dhëna del se tarifa e energjisë për këtë kompani është 48.16 €/MWh.

Pas kësaj KEK me datë 06 qershor 2011 i ka dërguar një shkresë Wind Power Sh.A me të cilën ka kërkuar se a pajtohet me tarifën e aprovar të ZRRE-së prej 48.16 €/MWh, dhe të dërgohet MBE për aprovim në ZRRE, në të kundërtën KEK-u do të detyrohet të shkyç instalimin e Wind Power në Golesh nga rrjeti i tij.

Wind Power Sh.A me datë 09 qershor 2011 i është përgjigjur KEK-ut duke theksuar se, Wind Power ka dërguar në ZRRE kërkesën për rishqyrtim të tarifës dhe se kërkesa është duke u shqyrta por që ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ana e ZRRE-së për rishqyrtim të tarifës, andaj kërkohet të mos shkyçet Wind Power Sh.A nga rrjeti i KEK-ut deri në marrjen e përgjigjes nga ana e ZRRE-së.

Wind Power Sh.A me datë 1 dhjetor 2011 ka dërguar në ZRRE një kërkesë për rishqyrtimin e tarifës së blerjes së energjisë për kontratën e nënshkruar nga Wind Power dhe KEK për energjinë që prodhohet nga tre gjeneratorët me erë të vendosura në Golesh.

Duke ju përgjigjur kërkesës së Wind Power të datës 01.12.2011, ZRRE me datë 21 gusht 2012 ka konstatuar se bazuar në nenin 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (LIGJI Nr. 03/L-201) i jep përgjegjësi ZRRE-së që t'i rregullojë të gjithë gjeneratorët me kapacitet të instaluar mbi 5 MW që ekzistojnë dhe janë në funksion me datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe duke marrë parasysh se gjeneratori i juaj nuk i përbush kushtet e këtij neni, gjeneratori i juaj nuk i nënshtrohet rregullimit të çmimit sipas nenit 41 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë (LIGJI Nr. 03/L-185). Gjithashtu theksohet se vendimi i ZRRE-së D\_359\_2011 përcakton tarifat nxitëse “feed-in” dhe aplikohet për blerjen e energjisë nga gjeneratorët që prodhjnë energji nga burimet e ripërtritshme të energjisë ku tarifat nxitëse janë të vlefshme vetëm për gjeneratorët me teknologji të re dhe me pajisje të reja, përderisa gjeneratorët tuaj kanë qenë të përdorur më herët, andaj ky vendim nuk lejon përcaktimin e tarifave nxitëse për ju. Gjithashtu ne shkresë është theksuar se gjeneratori në fjalë mund të negociojë lirshëm për tarifën e shitjes së energjisë elektrike me të gjithë akterët në treg duke përfshirë edhe Furnizuesin Publik.

Pas periudhës së privatizimit të Distribucionit, KEDS-i me datë 27.09.2013 i është drejtuar ZRRE-së me një shkresë lidhur me përcaktimin e çmimit për blerje të energjisë elektrike nga gjeneratori Wind



Power duke kërkuar nga ZRRE që të jep një pëlqim lidhur me çmimin e propozuar prej 60€/MWh para se të nënshkruajnë marrëveshjen për blerjen e energjisë me Wind Power.

ZRRE me datë 18 dhjetor 2013 i është përgjigjur KEDS-it dhe Wind Power lidhur me çmimin e propozuar nga KEDS-i prej 60 €/MWh, duke u pajtuar me këtë çmim si i arsyeshëm për investitorin, dhe ekonomikisht i pranueshëm për konsumatorët e rregulluar, në atë mënyrë që pasi të lidhet kontrata e shitblerjes së energjisë këto kosto do të jenë të bartshme në tarifa gjatë shqyrtimeve vjetore tarifore.

Me datë 5 shkurt 2014 KEDS-i dhe Wind Power kanë nënshkuar marrëveshjen për blerjen e energjisë në lidhje me kompleksin për gjenerimin e energjisë së erës me fuqi prej 1.35 MW (Bruto) në malin e Goleshit, ku çmimi i energjisë është 60 €/MWh.

ZRRE me datë 05.06.2015 ka njoftuar KEK-un se gjeneratori Wind Power ka iniciuar kontest për kompensim nga KEK-u lidhur me energjinë e prodhuar nga gjeneratorët e erës në Golesh, duke kërkuar nga KEK që të përgjigjet në ankesën e Wind Power.

KEK me datë 22.06.2015 i është përgjigjur ZRRE-së duke theksuar se KEK mbetet pranë çmimit të ofruar nga ZRRE-ja për blerje të energjisë nga Wind Power prej 48.16€/MWh. Gjithashtu KEK ne përgjigjen e saj ka theksuar se duke marr për bazë faktin se marrëveshja për blerjen e energjisë asnjëherë nuk është aprovuar nga ZRRE, KEK-u e ka pasur të pamundur të paraqes koston për mbulimin e obligimeve që dalin nga zbatimi i kësaj marrëveshje dhe kërkon nga ZRRE që në këtë kontest të marrë për shqyrtim edhe këtë kosto e cila nuk është mbuluar me tarifa.

Në mbledhjen e Bordit te mbajtur me datë 23.02.2016 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE në përputhje me nenin 14 paragrafi 6 të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, ka paraqitur Rekomandim para Bordit të ZRRE-së, i cili ka të bëjë me inicimin e kontestit nga Wind Power për kompensim nga KEK-u për energjinë e prodhuar nga gjeneratorët e erës në Golesh që përfshin periudhën 06/2010 deri 06/2011.

Bordi i ZRRE-së me shumicë votash, ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët dhe Rekomandimin e paraqitur nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, ku ka konstatuar se organi i shkallës së parë DMK, në rekomandimin e paraqitur ka analizuar në mënyrë profesionale gjithë periudhën kontestuese duke argumentuar faktet se nënshkrimi i Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (MBE) mes palëve me çmimin e "tarifës nxitëse" prej 84 €/MWh ka qenë në kundërshtim me Vendimin e Bordit të ZRRE-së nr. V\_141\_2008 të datës 19.12.2008, pasi në këtë vendim përcaktohen tarifat nxitëse (Feed-in) për prodhimin e energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e erës që përfshin vetëm kapacitetet gjeneruese me pajisje të reja. Bordi gjithashtu ka konstatuar se mos aprovimi i MBE-së nga ana e ZRRE-së përmes shkresës së datës 07.07.2010 ka qenë plotësish në përputhje me vendimin e lartcekur, pasi që gjeneratori Wind Power ka pasur pajisje të vjetra të përdorura në një lokacion tjetër, dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka mundur të përfshihet në tarifën nxitëse prej 84 €/MWh.

Nga shkresat e lëndës të prezantuara nga palët Bordi ka vërtetuar se edhe përkundër mos aprovimit të MBE-së, kompania Wind Power Sh.A ka filluar prodhimin e energjisë elektrike në periudhën qershor 2010 deri më qershor 2011 dhe këtë energji e ka plasuar në rrjetin e shpërndarjes së KEK-ut e cila energji është shpenzuar nga konsumatorët por që KEK-u asnjëherë nuk e ka paraqitur si shpenzim në proceset e shqyrtimeve tarifore në ZRRE.

Bordi me shumicë votash ka konstatuar se ZRRE pas shqyrtimit të marrëveshjes së MBE-së në mes KEK dhe Wind Power me të drejt dhe në mënyrë profesionale ka analizuar të dhënat fillestare te paraqitura nga kompania Wind Power ku si çmim fillestari ka dal të jetë çmimi prej 48.16 €/MWh.



Bordi i ZRRE me shumicë votash po ashtu ka konstatuar dhe ka evidentuar se ZRRE ka pas mungesë të kuorumi për të marr vendim për ketë çështje për shkak të mungesës së Kryesuesit dhe dy anëtarëve të Bordit të ZRRE-së. Gjithashtu duhet theksuar se para kompletimit të Bordit të ZRRE-së është bërë edhe plotësim/ndryshimi i Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 2004/10) i cili ligj e ka obliguar ZRRE për aprovimin e MBE, ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit të ri (Ligji Nr. 03/L-201), ZRRE nuk ka kompetencë të bëjë aprovimin e MBE, si dhe sipas nenit 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike theksohet se çdo gjeneratorë me kapacitet të instaluar mbi 5 MW i nënshtrohen rregullimit të çmimit sipas nenit 41 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë.

Bordi me shumicë votash ka konstatuar se shkresa e ZRRE-së e datës 16.08.2012 ka qenë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 03/L-201, në të cilën është theksuar se për shkak se gjeneratorët e Wind Power janë me kapacitet më të vogël se 5 MW nuk i nënshtrohen rregullimit të çmimit sipas neni 41 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë, si dhe i është kërkuar që të dalin lirshëm në treg dhe të negocijnë tarifën e shitjes së energjisë elektrike me të gjithë akterët në treg, duke përfshirë edhe Furnizuesin Publik. Për më tepër vërtetohet se palët kanë dështuar të arrijnë një marrëveshje për tarifën e shitjes së energjisë elektrike edhe përkundër udhëzimeve të dhëna nga ZRRE si në shkresën e lartcekur, dhe si pasojë e mos arritjes së një marrëveshje të tillë ka mbetur e pazgjidhur çështja e tarifës dhe shitja e sasisë së prodhuar nga gjeneratorët e erës për periudhën 06/2010 deri më 06/2011.

Bordi i ZRRE-së më shumicë votash ka konstatuar se pas procesit të privatizimit të OSSH-së dhe FP-së është vështirësuar edhe më tepër çështja e zgjidhjes së Marrëveshjes për Blerje të Energjisë mes KEK dhe Wind Power për faktin se pas kësaj periudhe KEK-u në bazë të licencës ushtron vetëm aktivitete të gjenerimit dhe jo të Furnizuesit Publik. Për më tepër me datë 05.02.2014 gjeneratori Wind Power dhe KEDS kanë nënshkruar marrëveshjen për blerjen e energjisë së prodhuar nga era dhe janë pajtuar që çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga KEDS-i të jetë me 60€/MWh. ZRRE edhe përkundër që nuk ka pasur obligim ligjor të bëjë aprovime të MBE-ve, megjithatë i është përgjigjur KEDS-it me shkresë duke vlerësuar se çmimi i propozuar është i arsyeshëm për investitorin dhe ekonomikisht i pranueshëm për konsumatorin e rregulluar, pasi që këto kosto pas nënshkrimit të marrëveshjes do të jenë të bartshme në tarifa gjatë shqyrtimeve vjetore tarifore.

Bordi i ZRRE-së me shumicë votash, ne mbledhjen e mbajtur me datë 23.02.2016 pas analizimit te gjitha shkresave të lëndës dhe rekomandimin e DMK-së, ka ardhur ne përfundim se është e domosdoshme që të zgjidhet çështja e kompensimit dhe pagesës nga KEK-u, gjeneratorit Wind Power për energjisë e prodhuar përmes erës. Gjithashtu është konstatuar se vendosja e çmimit prej 60€/MWh është marr duke u bazuar ne te dhënat e siguruara nga gjeneratori si dhe është marr për bazë edhe marrëveshja e arritur mes KEDS dhe Wind Power. Bordi me vendosjen e kësaj çështje ka konstatuar se çmimi prej 60€/MWh është i arsyeshëm për investitorin dhe ekonomikisht i pranueshëm për konsumatorët e rregulluar, i cili çmim është marrë përbazë gjatë përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së me shumicë votash gjatë marjes së këtij vendimi është mbështetur edhe në dispozitat ligjore te nenit 1, paragrafi 3, nën paragraghi 3.1, 3.3 dhe 3.4 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë të cilat dispozita përcaktojnë se, ZRRE ka përgjegjësi për rregullimin e sektorit të energjisë: duke siguruar funksionim transparent dhe jodiskriminues të tregjeve të energjisë bazuar në parimet e tregut të lirë sa i përket aktiviteteve konkurruese; të sigurojë kryerjen e aktiviteteve të energjisë në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese, që janë lëndë e detyrimeve të shërbimit publik, si dhe sigurimin e qasjes jodiskriminuese në sistemin e shpërndarjes; të sigurojë se tarifat e rregulluara për aktivitetet e energjisë janë të arsyeshme dhe të vendosura në bazë të një metodologjë të shëndoshë tarifore.





Pas analizimit të të gjitha dëshmive të prezantuara nga palët në kontest dhe Rekomandimin e paraqitur nga DMK, Bordi i ZRRE-së me shumicë votash, vendosi që kërkesa e gjeneratorit Wind Power për kompensimin e energjisë së prodhuar e regjistruar në rrjetin elektrik për periudhën 06/2010 deri më 06/2011 është e arsyeshme dhe për ketë gjeneratori duhet të paguhet. Andaj duke marr përbazë ketë dhe krejt atë që u theksua më lart u vendos si në diapositivin e këtij vendimi.


- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar

  
Arsim Janova, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Sejfijaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Kompanisë Wind Power,
- KEK-ut, dhe
- Arkivit të ZRRE-së